



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 07 REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ
NGA PARTIA ORA SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Partia Ora e Shqipërisë

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr.10, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 Belsh "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Belsh.

BAZË LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68, 71, 72, 73, 124, 133, 134, 135 pika 3, 143 pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,

VËREN

Partia Ora e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.07, datë 28.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i vendimit nr.10, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 Belsh "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Belsh, propozuar nga subjekti politik Partia Ora e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 30.05.2019, ora 17:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.07 regj., sipas objektit të sipërcituar.



Në mbledhjen e datës 30.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 07 subjekti ankues i vetëm, është Partia Ora e Shqipërisë.

- Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 28.05.2019 pretendon se:

Me vendimin nr.10 datë 25.05.2019 të KZAZ nr.45, Bashkia Belsh, ka vendosur "Për mosregjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Belsh, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

Subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë më datë 14.05.2019 me nr.3324/1 prot., ka depozituar pranë KQZ-së, formularët e vetëdeklarimit sëbashku me CV për të gjithë kandidatët e listës shumemërore të këshillit bashkiak Belsh në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Belsh.

Vendimi i sipërcituar i KZAZ-së nr.45, Bashkia Belsh, "Për mos regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e bashkisë Belsh, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit përkatësisht formularët e vetëdeklarimit sipas ankuesit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palës ankuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për nevoja të hetimit administrativ, vendosi të administrojë kryesisht në përputhje me nenin 136, pika 2 dokumentacionin e depozituar nga Partia Komuniste e Shqipërisë pranë zyrës së protokollit të KQZ-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se me shkresën me datë 14.05.2019, të Partisë Ora e Shqipërisë ka depozituar në KQZ, formularët e vetëdeklarimit sëbashku me CV për të gjithë kandidatët e listës shumemërore, pranë KQZ-së.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", subjekti Partia Ora e Shqipërisë ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, për të gjithë kandidatët e listës shumemërore të këshillit bashkiak Belsh si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i anëtarit të këshillit të bashkisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të formularëve të vetëdeklarimit, rezulton se ky dokumentacion është depozituar në KQZ, brenda aftit të parashikuar nga neni 73, pika 2 i Kodit zgjedhor për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit. KQZ vendosi administrimin e formularëve të vetëdeklarimit si prove dhe ti pranojë si pjesë integrale të dokumentacionit të kandidimit të cilin subjekti ankues e ka depozituar në KQZ.

Nga verifikimi i të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, rezulton se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". KQZ në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit



të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015" është në proces verifikimi të formularëve të vetëdeklarimit për t'ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Gjyqësore si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 30.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për anëtar këshilli në Bashkinë Belsh, të depozituar nga Partia Ora e Shqipërisë dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Ora e Shqipërisë është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 143, pika 1, germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të vendosë ndryshimin e vendimit nr.10, datë 25.06.2019 "Për mos regjistrimin e listës shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Belsh të KZAZ-së nr.45 dhe regjistrimin e listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor Partia Ora e shqipërisë për këshillin e Bashkisë Belsh, që mbyllet me nr rendor 21.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68, 71, 72, 73, 124, 133, 134, 135 pika 3, 143 pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 10, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Belsh" dhe regjistrimin listës shumëmemërore të Partisë Ora e Shqipërisë, për këshillin e Bashkisë Belsh që mbyllet me numër rendor 21.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

